

**William R. Hite, Jr., Ed.D.**  
**Superintendent**

25 Gusht, 2021

Të dashur familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Të Martën, më 31 Gusht, do të fillojmë vitin shkollor 2021-22 me mësim në – person pesë ditë në javë. Ne kemi vazhduar të punojmë ngushtë me kolegët tanë në Departamentin e Shëndetit Publik në Filadelfia (PDPH) dhe Spitalin e Fëmijëve në Filadelfia (CHOP) për të monitoruar kushtet e COVID-19 dhe për të identifikuar masa shtesë të shëndetit dhe sigurisë që mund të ndërmarrim për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien në të gjitha shkollat tona . Po shkruaj për të ndarë me ju dy azhurnime të rëndësishme.

### **Mandati i Vaksinës COVID-19**

Mbrëmë, Bordi i Arsimit votoi për të mandatuar vaksinën COVID-19 për të gjithë personelin. Unë e mbështes plotësisht këtë vendim sepse shkenca është e qartë: vaksinat COVID-19 funksionojnë. Një [studim i fundit nga CHOP](#) duke përdorur të dhëna nga shkollat tona është dëshmi e mëtjshme se vaksina është shumë efektive në parandalimin e përhapjes së COVID-19.

Ne jemi duke punuar me detajet përfundimtare tani dhe do të japim më shumë informacion kur të jetë e disponueshme.

### **Testi COVID-19 Për të Qëndruar në Model Përditësimi**

Me udhëzime të reja nga PDPH, ne nuk planifikojmë të ndjekim modelin” *Test to Stay*” . Kushdo që identifikohet se ka ardhur në kontakt të ngushtë me një person që teston pozitivisht për COVID-19, do t’i kërkohet të izolohet për 10 ditë.

Këto azhurnime të shëndetit dhe sigurisë janë përveç masave të tjera të sigurisë që do të kemi në çdo shkollë, duke përfshirë kryerjen e testimit javor të të gjithë personelit, sigurimin e testimit në vend të nxënësve që paraqiten me simptoma të ngjashme me COVID-in gjatë shkollës dhe që kërkojnë të gjithë në shkollat tona të mbajnë maskë, pavarësisht nga statusi i vaksinimit. Për të mësuar më shumë, sigurohuni që të rishikoni [protokollet e përditësuara të shëndetit dhe sigurisë](#), shikoni këtë: [What we’re Doing to Support Healthy & Safe in – Person Learning Video](#) dhe vizitoni qendrën tonë të informacionit të shkollës në [www.philasd.org /ring the bell](http://www.philasd.org/ring_the_bell).

Ne jemi të gëzuar dhe të gatshëm për të mirëpritur me siguri fëmijët përsëri në shkollë! Ju ftoj të vizitoni ndalesat tona të fundit në [Back-to-School Bus Tour](#) për të marrë informacione, shërbime dhe një çantë shpine falas me pajisje shkollore, në mënyrë që të jeni gati për vitin e ri shkollor.

Sinqerisht,

A handwritten signature in black ink that reads "William R. Hite Jr." in a cursive style.

William R. Hite Jr., Ed.D.

Superintendent

Drejtoria Arsimore e Filadelfias